



Në bazë të nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 17 pika “d” e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 14 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05Nr.391/02-19706/23 dt. 26.01.2023, të kërkesve / bashkëpronarëve, Milazim Veliu, Skender Shabani, ”4A” sh.p.k., Agim Sinani, Muhamer Mehmeti, Astrit Ajeti, Abdylhamid Ajeti, Sabri Ajeti, Kadri Ajeti, Behxhet Ajeti, Sebadin Islami, Avni Ruhani, Agron Ruahni dhe Femi Ruhani nga Prishtina dhe investitorit N.P.SH. ”4A” sh.p.k., me seli në Prishtinë, në rr. “Adrian Krasniqi”, dhe me përfaqësues Arif Dermishi nga Gjakova, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, për ndërtesat shumëbanesore me afarizëm me dy hyrje, të ndërtuara në kuadër të bllokut urban “J”, të Planit Rregullues “Dodona”, në rr. “Adrian Krasniqi”, në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës në procedurë administrative, me datë 13.03.2023, lëshon këtë:

CERTIFIKATË E PËRDORIMIT

I. I LEJOHET kërkesve / bashkëpronarëve, Milazim Veliu, Skender Shabani, ”4A” sh.p.k., Agim Sinani, Muhamer Mehmeti, Astrit Ajeti, Abdylhamid Ajeti, Sabri Ajeti, Kadri Ajeti, Behxhet Ajeti, Sebadin Islami, Avni Ruhani, Agron Ruahni dhe Femi Ruhani nga Prishtina dhe investitorit N.P.SH. ”4A” sh.p.k., me seli në Prishtinë, dhe me përfaqësues Arif Dermishi nga Gjakova, sipas kërkesës 05Nr.391/02-19706/23 dt. 26.01.2023, përdorimi i ndërtesës shumëbanesore me afarizëm me dy hyrje, me etazhitet 2B+S+P+7, e ndërtuar sipas Aktvendimit të Lejes Ndërtimore 05Nr.351/02-96303/21 dt.29.07.2021, dhe Vendim për ndryshimin e projektit kryesor të miratuar aktin administrativ “Vendim për lejimin e ndërtimit 05Nr.351/02-96303/21 dt.29.07.2021”, të datës 30.11.2023, në parcelën kadastrale nr. 10401-0, e evidentuar në certifikatën e pronësisë P-71914059-10401-0, ZK Prishtinë, konkretisht në kuadër të bllokut urban “J”, të Planit Rregullues “Dodona”, në Prishtinë.

II. Ndërtesat nga pika I. e këtij vendimi, ndodhet në rrugën “Adrian Krasniqi” ku kanë dalje hyrjet e kësaj ndërtese me numrat: 69, 71, 73, 75, 77, 79, 81, 83, 85, 87, 89, dhe 91, në Prishtinë, dhe e njejta do të përdoret dhe shfrytëzohet sipas destinimit të caktuar me leje ndërtimi dhe dokumentacionin ndërtimor, nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi të certifikatës së përdorimit.

III. Kjo Certifikatë do të shërbejë si bazë për regjistrimin e ndërtesës dhe njësive të saja në evidencat e regjistrit kadastral.

VI. Pjesë përbërëse e këtij vendimi të certifikatës së përdorimit është dokumentacioni sipas Shtojca 5 e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit.

A r s y e t i m

Kërkesve / bashkëpronarëve, Milazim Veliu, Skender Shabani, ”4A” sh.p.k., Agim Sinani, Muhamer Mehmeti, Astrit Ajeti, Abdylhamid Ajeti, Sabri Ajeti, Kadri Ajeti, Behxhet Ajeti, Sebadin Islami, Avni Ruhani, Agron Ruahni dhe Femi Ruhani nga Prishtina, me investitor N.P.SH. ”4A” sh.p.k., me seli në Prishtinë, dhe me përfaqësues Arif Dermishi nga Gjakova, me kërkesën me 05Nr.391/02-19706/23 dt. 26.01.2023, i janë drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e certifikatës së përdorimit për

Faqe 1 prej 3

ndërtesën afariste & banesore me dy hyrje, me etazhitet 2B+S+P+7, e ndërtuar në kuadër të bllokut urban "J", të Planit Rregullues "Dodona", në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale nr. 10401-0 ZK Prishtinë, ndërtuar sipas Aktvendimit të Lejes Ndërtimore 05Nr.351/02-96303/21 dt.29.07.2021, dhe Vendim për ndryshimin e projektit kryesor, të miratuar aktin administrativ "Vendim për lejimin e ndërtimit 05Nr.351/02-96303/21 dt.29.07.2021", të datës 30.11.2023, të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizimit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit e Komunës së Prishtinës si dhe pranuar teknikisht nga komisioni përkatës.

Paraprakisht Drejtoria e Inspeksionit-Sektorit i Ndërtimit i Komunës së Prishtinës, përmes shkresave zyrtare "Akt përcjellës", me referencë 09 Nr. 391/02-259107/22 dt. 23.01.2023, ka përcjellë në Drejtorinë e Urbanizimit, Raportet e Inspeksionit Final të punëve dhe përshkrimet të dokumentacionit, hartuar nga ekipi profesional i Drejtorisë së Inspeksionit të Komunës së Prishtinës.

Me kërkesë, kërkesit kanë prezantuar dokumentacionin sipas Shtojca 5 të e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit: Lista kontrolluese e Protokollit të Inspeksionit/1.Inspeksioni i themelit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspeksionit/2.a.1.Inspeksioni i pjesëve strukturore-Strukturave të betonit para instalimit të derdhjes; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspeksionit/2.a.2.Inspeksioni i pjesëve strukturore-Strukturat e betonit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspeksionit/2.c.Inspeksioni i pjesëve strukturore-Strukturat e çelikut; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspeksionit/2.d.Inspeksioni i pjesëve strukturore-Strukturat e drurit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspeksionit/3.Inspeksioni i instalimit elektrik; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspeksionit/4.Inspeksioni i instalimeve të ujit; Fotografitë gjatë procesit të ndërtimit; Dëshminë mbi pagesën e lejes ndërtimore; Atestet e materialeve dhe rezultatet e testeve, certifikatat; Raportin e përfundimit të punëve të arkitekturës, nga mbikëqyrësi Fitnete Gorçaj; Raportin e përfundimit të punëve të konstruksionit, nga mbikëqyrësi Bujar Emra; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, nga mbikëqyrësi Zarife Sallahu; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve elektike, nga mbikëqyrësi Ismet Krasniqi; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve makinerike, nga mbikëqyrësi Vedat Sjenicaku; Incizimin gjeodezik të objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01, nga gjeodeti i licensuar Faton Bajselmani me nr. të licensës 125;

Kjo drejtori, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, mendimit profesional të organit kompetent, Raportet e përfundimit të punëve, sipas fazave, dhe Raportin e Inspeksionit Final, ka konstatuar se:

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve të fazave të ndërtimit: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, konstatohet se punët janë zhvilluar në harmoni me dokumentacionin ndërtimor/projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht ndërtesa shumëbanesore me afarizëm mund të përdoret.

Bazuar në nenin 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe dispozitat e nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, ku thuhet se lëshimi i certifikatës së përdorimit mund të bëhet nëse kërkesat nga Ligji për Ndërtim janë plotësuar, organi kompetent lëshon certifikatën e përdorimit brenda kohës së caktuar.

Andaj, bazuar në konstatimet e mësipërme dhe në raportet e prezentuara-bashkangjitura në kërkesë, kjo drejtori konstatoi që ndërtesa shumëbanesore me afarizëm mund të përdoret, gjegjësisht vendosi të lëshojë certifikatën e përdorimit për ndërtesat shumëbanesore me afarizëm.

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate.

Udhëzimi juridik: Pala e pakënaqur me këtë Vendim, përmes kësaj Drejtorie, me ankesë mund t'i drejtohet Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, brenda afatit prej 30 ditësh duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij Vendimi. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI-ja.

I dorëzohet: Kërkuesit/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR. 391/02-19706/23 DT. 13.03.2023**

Zyrtarja,
Bahtije Vllasaliu


Udhëheqëse e Sektorit,
Nazife Krasniqi


Drejtori,
Arber Sadiki




